



VENDIM

Nr. 122, Datë 21.07.2016

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË
“PRELL ENERGY” SH.P.K NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “PRELLË” ME FUQI TË
INSTALUAR 14970 KW**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma ‘a’; 10 pika 3 të “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhenien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 21.07.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Prell Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë **“Prell Energy” sh.p.k.**, plotëson tërërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”; 4.1.4 gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe 4.1.5 gërmat “a”, “b”, “c”; është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për licensimin e shoqërisë “Prell Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Prellë” me fuqi të instaluar 14970 KW.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.